

VENDIM
Nr. 51, datë 1.2.2023

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për bashkëpunimin në fushën e diasporës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E DIASPORËS

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (këtej e tutje referuar si “Palët Kontraktuese”);

dëshirojnë të zhvillojnë dhe forcojnë marrëveshjet dypalëshe ekzistuese mes dy shteteve, duke synuar që të kontribuojnë në objektivat gjithëpërfshirës të bashkëpunimit midis dy shteteve;

të inkurajuar nga dëshira e përbashkët të promovojnë bashkëpunimin mes shteteve të tyre në fushën e diasporës;

të bindur që bashkëpunimi i tyre në fushën e diasporës është një instrument me vlera për forcimin e marrëdhënieve mes shtetasve të tyre;

janë dakorduar si vijon:

Neni 1

Palët kontraktuese do të mbështesin dhe do të zhvillojnë bashkëpunim në fushën e diasporës mes dy shteteve mbi parimet e barazisë dhe përfitimit reciprok.

Palët kontraktuese do të inkurajojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe programeve në fushën e diasporës. Palët kontraktuese do të inkurajojnë bashkëpunimin direkt ndërmjet institucioneve përgjegjëse të diasporës, i cili do të, realizohet përmes shkëmbimit të vizitave të drejtuesve dhe ekspertëve në fushat e përmendura, si dhe përmes konferencave apo aktiviteteve të përbashkëta.

Sipas mundësive, Palët kontraktuese bien dakord që të punojnë së bashku, duke iu referuar planit të përbashkët të veprimit në fushën e diasporës.

Palët kontraktuese do të angazhohen në programe të përbashkëta kulturore për diasporën, në çdo rast, si edhe kur të vlerësohet se është e nevojshme.

Palët kontraktuese do të mbështesin bashkëpunimin e institucioneve të tyre brenda kornizës së parimeve të Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Kombeve të Bashkuara dhe IOM-it.

Neni 2

Kjo Marrëveshje nuk do të ndikojë dhe nuk do të cenoj të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare.

Neni 3

Palët kontraktuese janë dakorduar që kjo marrëveshje nuk do të përjashtojë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit të cilat nuk janë të specifikuara, por të cilat do të jenë në përputhje me objektivat e saj.

Neni 4

Me qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të krijohet një Komision i përbashkët (këtu e tutje referuar si “Komisioni”), i përbërë nga përfaqësuesit e Palëve kontraktuese. Komisioni do të takohet periodikisht në Tiranë dhe Shkup, ndërsa datat e takimit do të dakordohen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Komisioni do të përgatisë programet periodike të bashkëpunimit, të cilat do të përcaktojnë detajet dhe kushtet e bashkëpunimit, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje dhe do të vlerësojnë dhe monitorojnë zbatimin e saj, si dhe do të vendosë për rekomandimet e duhura me qëllim të zbatimit efektiv të saj.

Neni 5

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me anë të negociatave ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Neni 6

Palët, në kuadër të veprimtarive në vendet respektive, do të përballojnë shpenzimet secili më vete.

Neni 7

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e pranimin të njoftimit të fundit me shkrim me të cilën palët kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, të kryerje procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Kjo Marrëveshje është përmbyllur për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh dhe automatikisht do të ripërtërihet për një periudhë pasuese prej 5 (pesë) vjetësh, vetëm nëse anulohet me shkrim nga njëra Palë kontraktuese përmes kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë, Marrëveshja do të përfundojë, pas 6 (gjashtë) muajsh nga data kur Pala tjetër kontraktuese ka pranuar njoftimin e anulimit.

Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e saj do të vazhdojnë të zbatohen për çdo marrëveshje të programit të këmbimit ose projekt të iniciuar sipas kësaj Marrëveshjeje dhe që është ende në zhvillim e sipër, deri në përfundimin e tyre, përveç kur Palët bien dakord ndryshe.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë dhe me kërkesë të njëres prej Palëve kontraktuese. Ndryshimet e miratuara do të hyjnë në fuqi sipas procedurave të parapara në paragrafin e parë të këtij neni.

Për vërtetim, të nënshkruarit e autorizuar, sipas rregullave të Qeverisë së tyre, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

E nënshkruar në Tiranë, më 5 shkurt 2021, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze, të gjitha tekstet me vlerë të njëjtë. Në rast të mosmarrëveshjeve, në interpretim do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Pandeli Majko

MINISTËR I SHTETIT PËR DIASPORËN

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Bujar Osmani

MINISTËR I PUNËVE TË JASHTME